



REPUBLICA E KOSOVES
REPUBLIKA KOS.
QENDRA PËR SHËRBIM TË QY
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA

Sh. 01 Nr. 22632
U. _____ Br. _____

Nr. i faq. 6 Data: 15/07
Br. str. _____ Datim: 2024

REPUBLICA E KOSOVËS
KAMENICË

REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E KAMENICËS

OPŠTINE KAMENICA / MUNICIPALITY OF KAMENICA



Procesverbali i mbajtjes së dëgjimit buxhetor me banorët e fshatit Muqiverc

Dëgjimi me banorët është organizuar nga Komisioni për organizimin e dëgjimeve buxhetore në bashkëpunim me Zyrën e Kryetarit dhe Kuvendin Komunal.

Njoftimet për qytetarët për organizimin dëgjimit buxhetor janë bërë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Publikimet janë bërë në Uebfaqe, në Facebook dhe në Platformën e Konsultimeve Publike.

Publikimet:

UBFAQE:

FACEBOOK:

<https://www.facebook.com/photo?fbid=884319030397097&set=pcb.884319097063757>

Me **05.07.2024** dëgjimi publik është mbajtur në fshatin Muqiverc duke filluar nga ora **20:03**.

Pjesëmarrës në këtë dëgjim ishin: Drejtoreshë e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Ardita Dërmaku, Drejtori I Drejtorisë së Urbanizimit, Uran Berisha, Drejtori për Investime Kapitale, Blerim Murina, Zyrtari Kryesor Financiar, Naser Hashani, zyrtarë të tjerë komunal përgjegjës për mbajtjen e dëgjimeve buxhetore, banorë të fshatit Muqiverc.

Drejtoresha Ardita Dërmaku ka hapur këtë dëgjim: Kam knaqsin të ndaj me juve detajet kryesore të buxhetit për vitin e ardhshëm, me theks të veçantë sa i përket investimeve kapitale dhe subvencioneve. Kjo është një mundësi që të merrni pjesë aktivisht në planifikimin dhe shpërndarjen e resurseve tona të ardhshme. Sygjerimet dhe komentet e juaja kanë një rëndësi shumë të madhe sepse bashkarisht më kërkesat e juaja do ta përfitojmë një draft buxhet për vitin e ardhshëm. Buxheti komunal i planifikuar për vitin 2025 do të jetë 15,282,684.00euro 5.10% më shumë se në vitin e kaluar, ku pjesa e dedikuar për investimeve kapitale arrin shumën 2.6 milion, ndërsa pjesa për subvencione arrin shumën 885,000.00 euro. Nga ju pres një kontribut të madhë ku gjatë këtij takimi pres që përmes prioriteteve të juaja ti paraqitni në ato kërkesa që ju i konsideroni më të rëndësishme në fshatin Muqiverc.

Më pas Zëdhënsja e Komunes, Lidiona Marovca ka prezantuar punët që janë bërë vitin e kaluar dhe janë në proces: janë 6 rrugë që do të shtrohen në fshatin e juaj, e që janë në procedurë të

prokurimit. Në fshatin e juaj është bërë asfaltimi i rrugëve, “Sherif Spahiu”, rr. “Msimtorja e Parë”, rr. “Hasan Nuh Spahiu”, këto janë rrugët të cilat janë asfaltuar, gjithashtu fillon edhe zgjerimi i rrugës Kollolëq, Dajkoc dhe Muqiverc, kyqjet në ujësjellës, një biznes përfitues i grantit të komunës, 5 banor përfitues të bursave për studentët, furnizimi i shkollës me smart TV, laptop si dhe furnizimeve të tjera të shkolles, rekuizitat sportive, kabineti i shkencave natyrore, transporti i nxënësve. Gjithshtu rrugët e reja të cilat kanë me u shtrua janë; asfaltimi i rrugës “Hoxhë Hasan Masurica” degëzimi 1,2 dhe 3, asfaltimi i rrugës “Ruzhdi Spahiu” dhe asfaltimi i rrugës “Mali” në gjatësi prej 200m, këto janë rrugë në tenderim e sipër dhe do të fillojnë punët shumë shpejt.

Kërkesat e banorëve ishin të ndryshme si:

Kryetari i Këshillit të fshatit Albert Thaqi: Ju falemnderoj për bashkpunimin, kërkesat që i kemi pas në vitin e kaluar janë realizuar shumica, në vitin e kaluar i kemi pas disa prioritete për disa rrugë që nuk kanë ende në prioritet, ajo që kam mujt me identifikuar problemet në fshat janë problem i ujërave atmosferik rruga Hasan Masurica, kanali është shumë i ngusht nuk mund të përballohet uji hyn nëpër shpija. Unë e shoh si një prioritet me të rëndësishëm për rregullimin e ujit atmosferik. Rregulli i vades në rrugën kryesore. Prroni në Fshat.

Banori Adem Hashani : Projekti që po flasim për ujrat sipërfaqësor, po bartet vit pas viti, ne e ngrimsim zërin vetëm kur ka të reshura, ky projekt ka nevoj të madhe të rregullohet dhe është shumë me prioritet, drunjët dekorativ kemi nevoj për zgjerim të projektit edhe në lagje të tjera. Rruga e malit a do të kryhet në këtë vit?

Drejtori Uran Berisha përgjigjet: Rrugët që u prezantuan janë në tenderim e sipër, dhe ky projekt duhet të kryhet. Të rruga Hasan Masurica që e ka edhe vaden është hy në trajtim. Rrugët që kanë me u shtrua në këtë vit, kanë me u trajtu edhe infrastrukturën nëntokësore, pastaj asfaltin. Për prroni ka dal edhe tenderi i këtij projekti.

Banori Milit Thaqi: unë kam një propozim, në lagjen time e kam rrugën pa asfalt, të asfaltohet rruga Nëntori i parë. Kam një pyetje dhe për drejtorin e Urbanizmit, a është kjo rruga që të qon për Dajkoc dhe të lidhë me Berivojce a është në projekt dhe ku janë procedurat?

Drejtori i urbanizmit përgjigjet: po kjo rrugë është në projekt dhe do të kryhet. Asfaltimi ka mbërritur deri te prroi i fshatit Berivojce pastaj do të vazhdoj me pjesën tjetër.

Banori Driton Hashani përfaqësues i lagjes Ismajl Hashani, jemi e vetmja lagje që nuk jemi të kyqur në rrejtin e ndriqimit publik, unë ka bërë kërkesë disa herë te drejtori i shërbimeve publike mirëpo asnjë herë nuk na është përgjigj, jemi e vetmja lagje që nuk kemi as asfalt, është rruga Ismajl Hashani degëzim i rrugës, ne shtyllat i kemi mirëpo drejtori nuk ka ndërmarre asgjë.

Banori Denis Spahiu: rruga “Sherif Spahiu” nuk ka ndriqim publik, një pjesë e trotuarit nga udhëkryqi deri te fshati Rogan- te muhagjirt, mungon një pjesë e trotuarit dhe mendoj që është rëndësishme sepse është e qarkullueshme.

Banori Afrim Keka: rruga “Mesojtorja e vjetër”, lagjja e Kekve, zgjerimi i ndriqimit publik, është e treta herë që bëjë kërkes, gjithshu një pjes e rrugës degëzim I rrugës ka mbet pa asfalt.

Banori Nexhat Spahiu: Degëzim I rrugës Hoxha Hasan Masurica , nuk ka emër lagjja. Ne e kemi ujësjellësin me ramje të lir, kan vendos shtyll e operatorëve të internetit dhe e ka ndërprer ujin, kam bërë ankes në komunë dhe nuk kam marë përgjigje.

Drejtori Uran: Komuna e Kamnicës është përfitues I një projekti me Agjensionin Katastral të Kosovës, që i rregullon të gjitha tabelat si dhe numrat e shtëpive, ndërsa emrat e rrugëve janë të vendosura dhe nuk mund të ndryshohen.

Banori : kur jemi tek tabela e rrugëve, a mundemi të i ndryshojm emrat e rrugëve?

Drejtori Uran: ndryshimi I emrave të rrugëve është në listë rezerv, dhe duhet të bëhet vetëm në bazë të asaj liste, sepse ndryshe ligji nuk e lejon ndryshimin e emrave të rrugëve.

Banori Qemajl Bojku: rruga që lidhë Arat, Pajazit Bjku nga xhamia e deri të lumit, që të bëhet hapja e rrugës, me gjatësi afër 1000 metra.

Banori Albulent Spahiu: Rruga “Ruzhdi Spahiu”, është e regjistruar në kadastër, shtylla ekziston mirë po nuk është tabela. A duhet me ba kërkes që të vendoset tabela, asfaltim i rrugës “Rexhep Spahiu”.

Kryetari I Kshillit Albert: rruga “Nëntori i Parë”, te varresat, është rrugë e pa asfaltuar -350 metra gjatësi, zgjerimi i rrjetit të ndriqimit degëzim i rrugës së Malit, shtyllat janë është rrugë kryesore banorët e fshatit e përdorin si shëtitore.

Banori Denis Spahiu: fshati jon ka nevoj më së shumti për trotuare, si dhe mirembajtjen e parqeve dhe varrezav.

Banori Driton Hashani: sa I përket varrezave a është ndërmarrë ndonjë veprim, a është caktuar ndonjë lokalitet tjetër?

Zyrtari Naser përgjigjet: në kuvend është marë një vendim, është vendos një pjes ka Nexhmedin Keka.

	Propozuesi	Propozimi	Formë e Kontaktit
1.	Albert Thaqi	Ujrat atmosferik, rr. “Hasan Masurica”-Zgjerimi I gypave, Rregullimi i vades në rrugën Kryesore, Rregullimi i Prroit të fshatit, Asfaltimi I rr. “Nëntori I Parë” 350metra, Zgjerimi i rrjetit të ndriqimi public – degëzim I rr. së “Malit”.	Me telefon


2.	Adem Hashani	Rregullimi I ujrave atmosferik, Zgjërimi I projektit për drunjët dekorativ.	Me telefon
3.	Milit Thaqi	Asfaltimi I rr. "Nëntori I parë".	Me telefon
4.	Driton Hashani	Asfaltimi I rr. "Ismajl Hashani", degëzim i rrugës, Shtritja e rrjetit të ndriqimit Publik.	Me telefon
5.	Denis Spahiu	Shtritja e e rrjetit të ndriqimit Publik, rr. "Sherif Spahiu", Vazhdimin e trotuarit , nga udhëkryqi I fshatit deri në fshatin Rogan, rr. Kryesore, Mirëmbajtja e parqeve dhe Varrezave.	Me telefon
6.	Afrim Keka	Asfaltimi I rr. "Mësonjtorja e Parë" –degëzim, Zgjerim I ndriqimit publik.	Me telefon
7.	Nexhat Spahiu	Emërtimin e rr. degëzim I rr. " Hoxhë Hasan Masurica". Riparimin e dëmit nga operatori, dëmtim I gypit të ujës-jellësit.	Me telefon
8.	Qemajl Bojku	Hapja dhe zgjërimi I rr. "Pajazit Bojku-Arat" gjatësi 1000m.	Me telefon
9.	Albulent Spahiu	Asfaltimi I rr. "Ruzhdi Spahiu", Vendosja e Tabelva Emërtuese.	Me telefon
10.			Me telefon

Të gjitha këto kërkesa të banorëve janë evidentuar nga anëtarët e komisionit për organizimin e dëgjimeve buxhetore, dhe ato që kanë prioritet më shumë do të inkorporohen në projekt buxhet.

Pasi që nuk kishte më kërkesa nga banorët, takimi ka mbaruar në orën 20:50.

Procesmbajtëse:

Samire Krasniqi,





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Lista e pjesëmarrjes së qytetarëve për dëgjimin buxhetor në Muçivërc





Data: 05.07.2024

Ora: 20:00

Nr.	Emri dhe mbiemri	Numri i telefonit	Email adresa	Gjinia	Përkatesia etnike	Nënshkrimi ¹²
1.	MILIT THAGI			MASHKULL	SHQIPTAR	
2.	QEMAJI BOKU			M	shqiptar	
3.	ADEN HASHANI			M	shqiptar	
4.	Ahrim Keka			M	shqiptar	
5.	Mexhat Hadri			M	shqiptar	
6.	Dejton HASANI			M	shqiptar	
7.	DEXHIS SPAHIIJA			M	shqiptar	
8.	Abdulent Spahiu			M	shqiptar	

¹ SHQ: Me këtë nënshkrim, i jap leje të plotë Komunës për të më fotografuar, dhe për të bërë xhirime të imazhit dhe zërit tim me qëllim të përmbytjes për komunikim, si dhe ta përdorë këtë për çdo media, qoftë elektronike apo të shtypur. SRB: Ovim potpisom dajem punu dozvolu Opština da me fotografise i snima mene i moj glas u svrhu kreiranja komunikacionog sadržaja, kao i da isto koristi za bilo koji medij, bilo da je elektronski ili štampar.

² SHQ: Me këtë nënshkrim, unë jap pëlqimin tim që Komuna të përpunoj të dhënat e mia personale për qëllime të ligjshme, në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Kosovë. SRB: Ovim potpisom dajem svoju saglasnost da Opština obraduje moje lične podatke u zakonske svrhe, u skladu sa Zakonom o zaštiti podataka o ličnosti na Kosovu.

Nr.	Emri dhe mbiemri	Numri i telefonit	Email adresa	Gjinia	Përkatesia etnike	Nënshkrimi ¹²
9.	Ardan Spahiu			M		
10.	Rekhep Arifi			M	M.	
11.	Alberst Thaqi			M	SH.	
12.	Sharif Tassei			M	AL.	
13.						
14.						
15.						
16.						
17.						
18.						
19.						
20.						
21.						
22.						
23.						
24.						

¹ SHQ: Me këtë nënshkrim, i jap leje të plotë Komunës për të më fotografuar, dhe për të bërë xhirime të imazhit dhe zërit tim me qëllim të krijimit të përmbajtjes për komunikim, si dhe ta përdorë këtë për çdo media, qoftë elektronike apo të shtypur. SRB: Ovim potpisom dajem punu dozvolu Opština da me fotografise i snima mene i moj glas u svrhu kreiranja komunikacionog sadržaja, kao i da isto koristi za bilo koji medij, bilo da je elektronski ili štampan.

² SHQ: Me këtë nënshkrim, unë jap pëlqimin tim që Komuna të përdorë të dhënat e mia personale për qëllime të ligjshme, në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Kosovë. SRB: Ovim potpisom dajem svoju saglasnost da Opština obrađuje moje lične podatke u zakonske svrhe, u skladu sa Zakonom o zaštiti podataka o ličnosti na Kosovu.